



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:043061
Datë: 18.11.2024
Numri i dokumentit: 06470242

PKR.nr. 6/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, sipas Kryetari i trupit gjykues – gjyqtari Shaqë Curri, gjyqtarëve Sami Sharaxhiu dhe Musë Povataj anëtar të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta, në çështjen penale kundër të pandehurës B.M., për shkak të veprës penale, falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.11/24, të dt. 08.02.2024, mbajti seancën publike të shqyrtimit gjyqësor me dt.05.11.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit, Valbona Disha Haxhosaj, të pandehurës B.M., mbrojtësit të pandehurës av. sipas detyrës zyrtare dhe të dëmtuarës A. K. me dt. 07.11.2024 bie dhe shpallë publikisht, ndërsa me datë 18.11.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurës

B.M. e bija e dhe nënës, e vajzërisë, e lindur më dt. në rr.”” hyrja Kati nr....., P....., ku edhe banon, me profesion këngëtare/ soliste, e pamartuar, nënë e një fëmijë, e gjendjes së mesme ekonomike, e identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. personal:, posedues i nr. telefonit:, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTORE

Sepse,

Me datë 20.09.2022, rreth orës 16:00, në rr. “.....” në Pejë, e pikërisht në Qendrën estetike “.....”, e pandehura me qëllim të vënies në qarkullim si të vërtetë, e duke e ditur se është e falsifikuar, përdorë kartëmonedhën prej 100 €, në atë mënyrë që pasi e pandehura kishte kryer në sallonin e lartcekur 3 shërbime, njëherë 2 shërbime pra mollëzat dhe buzët, në shumë prej

225 euro, dhe ka paguar tek dëshmitarja B..... 225 euro përafërsisht, ku nga kjo shumë për kartëmonedhën në fjalë 100 euro, dëshmitarja ka dyshuar se është e falsifikuar dhe ia ka kthyer të pandehurës e cila më pas ia kishte dhënë 100 euro tjera, kurse herën e tretë kishte shkuar pas një ore, për me i shtu edhe 1mml tek mollëza në vlerë prej 150 euro, ashtu që e njëjta e bën prapë pagesën tek dëshmitarja B. K., me bankënotën prej 100 euro për të cilën edhe herën e parë dëshmitarja ka dyshuara, por i pranon me insistimin e të pandehurës nën betimin se e njëjta do ti jepte bankënotë tjetër nëse do rezultojë e falsifikuar, ashtu që dëshmitarja së bashku me të dëmtuarën A. K. pasi që kishin verifikuar në bankë e më pas edhe në këmbimore se kartëmonedha është e falsifikuar, e dëmtuara e kishte kontaktuar në telefon të pandehurën, mirëpo e njëjta edhe pse e kishte lënë takimin të njëjtën ditë me të dëmtuarën, nuk kishte shkuar e as nuk iu kishte përgjigjur të dëmtuarës në telefon, e më pas e dëmtuara rastin e ka paraqitur në Stacionin Policor në Pejë, me ç ‘rast nga policia ishte konfiskuar kartëmonedha në vlerë prej 100 euro, dhe pas raportit të ekzaminimit me nr.AKF/2022-3794/22-3680 të datës 20.10.2022, e njëjta ka rezultuar si falsifikim i plotë.

- me çka ka kryer veprën penale “Falsifikimi i parasë”, nga neni 296, par. 2 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata konform nenit 7, 38, 39, 46 ,47, 48, 49, 50, 69, 70, neni 296, par. 2 të KPRK-së dhe neni 364, të KPP-së, të pandehurës i shqipton:

DENIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim fare nuk ka për tu ekzekutuar në qoftë se e pandehura në afat prej 1 (një) viti nuk kryen veprë të re penale.

E pandehura obligohet që në emër të paushallit gjyqësor, të paguaj shumën prej 100 (njëqind) euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E pandehura obligohet që në emër të programin e kompensimit të viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara A. K. nga P., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest të rregullt juridiko civil.

Konform nenit 296 par 6 të KPRK-së, konfiskohet një bankënotë e falsifikuar, në vlerë (1x100) euro me nr. serik DB666880000, e cila pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi urdhërohet te shkatërrohet.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, ka ngrit aktakuzë Pejë, PP/L.nr.11/24, të dt. 08.02.2024, kundër të pandehurës B.M., për shkak të veprës penale falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 të KPK-së.

Gjykata me dt. 05.11.2024, ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor në praninë e Prokurorit të Shtetit, Valbona Disha Haxhosaj, të pandehurës B.M., mbrojtësit të pandehurës av. dhe të dëmtuarës A. K..

Meqenëse e pandehura nuk e ka pranuar fajësinë, shqyrtimi gjyqësor, ka vazhduar me administrimin e provave, në fillim është dëgjuar e dëmtuara A. K., pastaj është lexuar deklarata e dëshmitares B. K. e dhënë në Prokurori me dt. 07.02.2024, janë administruar provat materiale si, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm me nr. 2022-DA-1758, të dt. 23.09.2022, raporti i oficerit E. H., dt. 23.09.2022, raporti i ekspertimit, nr. AKF/2022-3794/22-3680, dt. 20.10.2022, foto dokumentacioni si dhe shkresat e lëndës.

Pas administrimit të provave e pandehura, ka kërkuar nga Trupi Gjykses që edhe njëher ti ipet mundësia të deklarohet lidhur me fajësinë.

Trupi Gjykses konform nenit 242 par 9 të KPRK-së, ka aprovuar kërkesën e të pandehurës që e njëjta të deklarohet për fajësinë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

E pandehura ka deklaruar se pasi që është konsultuar me mbrojtësin e tij, e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ndihet e penduar, premtan se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale, i kërkon falje të gjitha palëve në procedurë.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës, meqenëse një pranim i tillë ka mbështetje në provat në bazë të cilave është ngrit aktakuza.

E dëmtuara ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës.

Mbrojtësi i të pandehurës, ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë të bërë nga e mbrojtura e tij, pasi që një pranim i tillë ka mbështetje edhe në prova që gjenden në shkresat e lëndës, e njëjta pranimin e fajësisë e bëri me vullnet të lirë dhe të plotë, dhe pasi që të njëjtën e ka njoftuar me pasojat dhe privilegjet e pranimin të fajësisë, andaj kërkon nga gjykata që ta aprovojë pranimin e fajësisë.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës dhe se janë plotësuar kushtet nga neni 322 lidhur me nenin 242 par.6 dhe 9 të KPP-së për pranimin e fajësisë, shqyrtimi ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurorja e Shtetit, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqenëse e pandehura B.M., e pranoi veprën penale për të cilën akuzohet, në tërësi mbetet pranë aktakuzës, përshkrimin faktik dhe juridik të veprës penale, i propozon gjykatës të njëjtën ta shpall fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit, po ashtu i propozon gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë rënduese të vlerësojë dashjen e lartë për ta kryer këtë vepër penale, kurse si

rrethanë lehtësuese i propozon gjykatës ta vlerësojë pranimin e fajësinë dhe keqardhjen e shprehur për veprën penale për të cilën akuzohet .

E dëmtuara A. K., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet fjalën përfundimtare të Prokurores së Shtetit, sa i përket kompensimit të dëmit, heq dorë edhe nga kompensimi i dëmit dhe sa i përket dënimit ia lë në vlerësim gjykatës.

Mbrojtësi i të pandehurës, av., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se gjykatës i propozon që me rastin e marrjes dhe shqiptimit të sanksionit penal, të merr si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë nga e mbrojtura e tij, pendimin e thellë shprehjen e keqardhjes, faktin se e njëjta për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, e njëjta është nënë vetushqyese e një vajze të mitur, e gjendjes së varfër ekonomike, andaj e lut trupin gjykues që të shqiptojë një sanksion penal sa më të ulët , pasi që me çfarëdo lloj sanksioni penal do të arrihet qëllimi i dënimit, e duke pas parasysh që edhe qëllimi primar i dënimit nuk është hakmarrja, mirëpo riedukimi dhe risocializimi i të njëjtës.

E pandehura B.M., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën e mbrojtësit së saj dhe nuk ka tjetër çka të shtoj.

Trupi Gjykues, është i bindur se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurës është bërë konform dispozitave të nenit 242 par 6, lidhur me nenin 322 të KPP-së, pasi që e pandehura e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështetet aktakuza siç janë: vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm me nr. 2022-DA-1758, të dt. 23.09.2022, raporti i oficerit E. H., dt. 23.09.2022, raporti i ekspertimit, nr. AKF/2022-3794/22-3680, dt. 20.10.2022, foto dokumentacioni, si dhe shkresat e tjera të lëndës, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 242 par 6 të KPP-së, ka pranuar pranimin e fajësisë nga e të pandehurës.

Me provat e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurës B.M., qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale, falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 të KPK-së

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurës dhe e njëjta është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurën, gjykata mori pranimin e fajësisë, shprehjen e pendimit për veprën e kryer, faktin se pandehura me parë nuk ka qenë e dënuar për ndonjë vepër tjetër penale dhe është hera e parë që bie ndesh me ligjin. Rrethana rënduese për të pandehurën gjykata mori shkallen e lartë të dashjes për ta kryer veprën penale, pasi që e pandehurës edhe pse kartëmonedhën prej 100 euro, një herë nuk ja kishte pranuar e dëmtuara sepse kishte dyshuar se është e falsifikuar, e njëjta përsëri kishte shkuar pas një ore, ku kishte marrë edhe një shërbim nga e dëmtuara dhe përsëri e

bën pagesën tek dëshmitarja B. K., me bankënotën prej 100 euro, për të cilën edhe herën e parë dëshmitarja ka dyshuar.

Sipas bindjes së Trupit Gjykues, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurës. Trupi Gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurës nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e saj; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në nenin 449 par. 1 dhe 2 nënpar. 2.6 të KPPRK-së, gjykata të pandehurën e ka obliguar në paguarjen e paushallit gjyqësor në shumë prej 100 (njëqind) euro, duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri në përfundimin e saj.

Konform nenit 36 par.1, 2, 3, nënpar.3.2 të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 462 par 2 të KPP-së, palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Konform nenit 296 par 6 të KPP-së, të pandehurës i konfiskohet një bankënotë në vlerë (1x100) euro me nr. serik DB666880000, e cila pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi urdhërohet të shkatërrohet.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPP-së, gjykata përpiloj këtë aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.6/24, dt. 18.11.2024

Bashkëpunëtore profesionale
Selvane Bukleta

Kryetari i trupit gjykues
Shaqë Curri

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.